

KOMENTET MBI RREGULLIN PËR KUSHTET E PËRGJITHSHME TË FURNIZIMIT ME ENERGI

Komentet e bëra nga KEK-u:

Dokumentet Referuese

1. Kodi i Rrjetit
2. Kodet Teknike dhe Operacionale
3. Rregullat e Tregut
4. Rregulla për Procedurën e Zgjedhjeve të Mosmarrëveshjeve
5. Metodologjia e Taksave për Kyçje
6. Metodologjia e Tarifave
7. Kodi i Matjes

Dokumentet Shtesë që nevojiten

1. Ligji për Rregullatorin e Energjisë
2. Ligji për Energjinë Elektrike
3. Rregulli për Shkycjet dhe Rikycjet

Veprimet në të ardhmen

1. Shqyrtimi i Çmimeve, Neni 30.4 – shërbim i përkohshëm

Koment: I pranuar dhe do të përfshihet në Rregull

“marrëveshje për kyçje” nënkupton marrëveshjen ndërmjet operatorëve të sistemit dhe shfrytëzuesve të sistemit, që **përshkruan** procedurat e kyçjes, fillimit, mirëmbajtjes dhe përfundimit të kyçjes në sistem;

Koment: I pranuar pasi që fjalia shprehë kuptim më të mirë.

b) kërkojnë kyçje të objekteve dhe pajisjeve të tyre energjetike në rrjetin e operatorit të sistemit, nëse një kyçje e tillë është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, sipas dispozitave të Kodit të Rrjetit ose Shpërndarjes, ose të ndonjë kodi teknik ose rregulloreje tjetër të aplikueshme;; (çka në lidhje me zhvillimin special, aplikimit e diferencuar sipas zonave dhe aplikimin për tarifë grupore?)

Përgjegjëje : Për sa i përket aplikimit të diferencuar sipas zonave, është herët të aplikohet pasi që Planifikimi Hapësinor ende është në fazën fillestare dhe politika e ndërlidhur me të janë ende të panjohura për publikun e gjerë. Pasi që ne akoma nuk kemi mjaft informata për zhvillimet në të ardhmen dhe sa i përket Kosovës si territor relativisht i vogël ne në këtë fazë nuk konsiderojmë se duhet të ketë ndarje të zonave. Me përjashtim të grupit tarifor për Amvisëri dhe disa konsumatorëve komercial brenda grupit tarifor ...për të gjithë konsumatorët e tjerë kyçja do të bëhet në bazë të parimeve të vendosura në Metodologjinë e Tarifave në lidhje me kyçjen.

4.1. f) **Gjobat që duhet paguar ZRRE-së**, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim me shërbim dhe energji të cilësisë së dobët, në përputhje me marrëveshjet për furnizim dhe standardet e shërbimit që i ofrohet konsumatorëve, përfshirë cilësinë e shërbimeve, sigurinë dhe besueshmërinë e furnizimit të parashikuar në këtë marrëveshje.

Koment: Komenti nuk është pranuar pasi që gjobat janë kategori tjetër që do të aplikohen gjithashtu, dispozita në fjalë duhet kuptuar në atë mënyrë që ti kënaq kërkesat e konsumatorëve në rast të dështimit të furnizimit me standardet që kërkohet.

4.2. Furnizuesi duhet të: **(Departamenti i Furnizimit)**

Koment: Ky koment nuk mund të pranohet pasi që shprehë organizimin aktual të një kompanie të integruar vertikalisht e që mund të mos jetë në strukturën e ardhshme të furnizimit, përderisa procesi i ristrukturimit të sektorit të energjisë do të vazhdoi.

4.2. a) nënshkruajë marrëveshjen për kyçje dhe marrëveshjen kornizë me operatorët e sistemit në emër të vet dhe në emër të konsumatorëve; **(ne nuk e kemi këtë - - kjo duhet të jetë fokus i vëmendjes për të parandaluar konfliktin destruktiv dhe mos përqendrimin)**

Koment: Në të vërtet, ristrukturimi i KEK-ut është në një fazë shumë të hershme dhe është i kuptueshëm ky reagim por zhvillimet e mëtejshme kërkojnë nga furnizuesi si dhe nga furnizuesi publik hyrjen në tregun e energjisë që do të vendoset. Hyrja në tregun e energjisë duhet të sigurohet për të gjithë pjesëmarrësit në baza të barabarta që nënkupton të jetë tërësisht në përputhje me Rregullat e Tregut. Rregullat e Tregut parashohin hyrjen në marrëveshje që sigurojnë transparencë dhe trajtim të njëjtë për çdokënd që dëshiron të marrë pjesë. Kërkesë themelore është nënshkrimi i marrëveshjes për kyçje dhe shfrytëzim të sistemit. Furnizuesi Publik është subjekti që përdor sistemet qofshin ato të transmisionit apo distribucionit për të furnizuar konsumatorët e tij. Marrëveshjet e lartpërmendura në të kundërtën përcaktojnë marrëdhënie të qarta në mes Furnizuesit Publik dhe operatorëve të sistemit me qëllim që të mënjanojnë paqartësinë që aktualisht janë në marrëdhëniet në mes të subjekteve të ndryshme qofshin ato edhe në një kompani të integruar vertikalisht.

4.2. e) themelojë një departament përgjegjës për mbrojtjen, sigurimin e informacioneve, përkrahjen dhe këshillimin ndaj konsumatorëve; **Përfshirë shërbimin e konsumatorëve, ndriçimin e dobët , pajisjet për ngrohjen e ujit, hetime për faturat, ndërprerje të dritave, energjinë elektrike nga era etj.)**

Komenti : Komenti është pranuar përveç energjisë nga era e cila duhet të hiqet dhe në vend të saj do të jetë etj.

4.2. i) sigurojë konsumatorëve një përmbledhje me shkrim mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre **në kohën e nënshkrimit të Kontratës për Furnizim dhe pas aprovimit të ndryshimeve në këtë kontratë**, për sa i përket furnizimit me energji së paku një herë në vit;

Komenti: I pranuar.

4.2. j) që paraprakisht të paraqesë për rishikim dhe aprovim në ZRRE, formën dhe përmbajtjen e Kontratës për Furnizim **që i është ofruar konsumatorëve;**

Komenti: I pranuar.

4.3. Operatori i sistemit duhet të: **(Departamenti i Furnizimit: a do të komentojnë drejtpërdrejt me Rregullatorin apo nëpërmes Aliut)**

Pa komentë!

4.3. e) arkëtojnë prej shfrytëzuesve të sistemit tarifën e sistemit; **(Jo Furnizimi?)**

Përgjigje: Furnizuesi është shfrytëzues i sistemit dhe duhet ti paguaj operatorëve të sistemit për shfrytëzimin e shërbimeve të tyre

4.3. f) sigurojë lexim të saktë dhe të rregullt të njehsorëve; **(Jo Furnizimi?)**

Përgjigje: Operatorët e sistemit janë përgjegjës edhe për humbjet komerciale edhe për ato teknike. Operatorët e Sistemit janë përgjegjës për të ofruar të dhëna për faturim tek furnizuesi. Leximi i njehsorëve është irrelevant se nga kush do të bëhet, mund edhe të kontraktohet nga ndonjë tjetër, por TSO-ja dhe DSO-ja janë të thirrura të menaxhojnë të dhënat, të përkujdesen për humbjet dhe në të njëjtën kohë t'i ofrojnë furnizuesit të dhëna për faturim. Detalet duhet të parashihen në Marrëveshjet për Kyçe.

4.3. g) mbajë dhe rifreskojë të dhënat në lidhje me kyçjen, marrëveshjet për kyçe, aplikacionet për kyçe, aplikacionet për ndryshime; faturimin ndaj shfrytëzuesve të sistemit, ndërprerjet aksidentale dhe të planifikuara në furnizim dhe përputhshmërinë me kriteret e cilësisë, dhe të gjithë të dhënat e tjera në përputhje me dispozitat e Rregullave tjera të aplikueshme;; **(Jo Furnizimi?)**

4.3. h) rishikojë ankesat me shkrim në lidhje me çështjet e njehsorëve;; **(Jo Furnizimi?)**

Përgjigje: Ankesat e Konsumatorëve duhet të kalojnë përmes furnizuesit që do të thotë furnizuesi do të veproi në emër të konsumatorit në lidhje me operatorët e sistemit.

4.3. m) botojë në faqen elektronike zyrtare dhe gazetata ditore, deklaratën e aprovuar nga ZRRE-ja **(çfarë është kjo),**

Përgjigje: Do të jetë si në vijim m) botojë në faqen elektronike zyrtare dhe gazetata ditore, deklaratën mbi Metodologjinë e Taksave për Kyçe të aprovuar nga ZRRE-ja;

4.3 n) si dhe detyrime dhe përgjegjësi të tjera të përcaktuara në Nenet XX dhe ZZ të këtij Rregulli ?

Koment: të fshihet paragrafi n)

4.4. Çdo Furnizues dhe operator i sistemit është i detyruar që në pajtim me këtë Rregull të zhvillojë politika në lidhje me kushtet për kyçjen dhe furnizimin me energji **(kur ?)**. Të gjitha këto politika duhet të sigurojnë procedurë transparente dhe jo diskriminuese dhe t'i paraqiten ZRRE-së për rishikim dhe aprovim paraprakisht para hyrjes në fuqi. Këto politika duhet bërë publikisht duke qenë në dispozicion në faqen zyrtare elektronike, shtypin ditor, njoftime, raporte publike dhe çdo mënyrë tjetër që duket e përshtatshme për **publikim**.

Koment: Ky tekst do të shtohet pas fjalës Rregull në fjalinë e parë si në vijim "brenda afatit që nuk do të kaloj 90(nëntëdhjetë) ditë."

Komenti i dytë në lidhje me publikim nuk është i nevojshëm por nuk parandalohet nëse konsiderohet se është më i qëlluar.

5.1. (tani 6.1) Operatorët e sistemit duhet të zhvillojnë metodologjinë e taksave dhe procedurat për kyçe në përputhje të plotë me rregullën për "Metodologjinë e Tarifave" të aprovuar nga ZRRE-ja, e që përfshin taksat për:

a) **përpara** aktiviteteve të nevojshme për të skicuar, ndërtuar dhe mirëmbajtur kyçjen si përgjigje ndaj një aplikimi nga shfrytëzuesi i sistemit;

Komenti: I pranuar

5.1.) (tani 6.1) g) shkyçjen nga rrjeti dhe heqjen e pajisjeve (linjave, njehsorëve, gypave) si pasojë e shkyçjes. **(Jo Furnizimi?)**

Pyetje: Ka mjaft arsye për shkyçje. Në rast të mospagesës shkyçja do të bëhet nga OS me kërkesë të furnizuesit si dhe politikave në vijim mirëpo plotësisht në përputhje me Rregullën për Shkyçje të nxjerrur nga ZRRE-ja.

h) aktivizim të kyçjes jashtë funksionale në rastet e ndërprerjeve të punës së centralit energjetikë pasi që arsyet e ndërprerjes zhduken (**jo e mundshme në Kosovë – të fshihet?**)

Pa koment!

6. (tani 7) Bazuar në Metodologjinë e Taksave dhe procedurave për Kyçje, aplikuesi dorëzon aplikacionin e vet tek furnizuesi i cili e **procedon** tek operatorët e sistemit, sipas Aneksit A të këtij rregulli.

Komenti: I pranuar

7.2. (tani 8.2) Oferta për kyçje duhet të përmbajë elemente në lidhje me:

a) punët e kërkuara për zgjerim ose përforcim të rrjetit të bartjes dhe shpërndarjes; në këtë mënyrë i emërtuar si “**kyçje e thellë**”. **Si rregull kjo funksionon varësisht nga zonat e diferencuara për zhvillim. Kjo përfshinë disponueshmërinë e të gjitha shërbimeve dhe nevojën për nga aspekti i veçante i zhvillimeve të zonave të veçanta. Kostoja e punës del me kalkulimin e kostos shtesë të rrjeteve të përfunduara të konsumatorëve të kyçur ne pikat e ndryshme të distribucionit.**

Koment: Çështjen e shtruar duhet trajtuar me Metodologjinë e Taksave për Kyçjes. Ashtu siç përmendet në koment, zonat e diferencuara janë shumë të varura nga planifikimi i veçantë i cili në këtë fazë të zhvillimit nuk na jep mjaft mundësi se si të zhvillohen dispozitat e qarta. Për këtë arsye koment i në këtë fazë nuk mund të përfshihet dhe duhet të lihet për fazat e mëvonshme.

7.2 (tani 8.2) c) instalimin e njehsorëve të përshtatshëm të kërkuar që mundëson matjen e energjisë elektrike ose ngrohjes nga operatori i sistemit, në pikat hyrëse dhe dalje;

(1) Qasja dhe kriteret e sigurisë në pikat matëse.

Koment: Qasja në Pronë për qëllime të instalimit, matjes, leximit etj. është paraparë në Nenin 17. Kriteret për siguri duhet të zhvillohen nga Kodet Teknike.

7.3. (tani 8.4) Në përpilim të një oferte të marrëveshjes për kyçje ose të një përgjigje për një aplikacion për kyçje, operatori i sistemit duhet të vendosë:

c) si dhe kushtet tjera të detajuara në respekt të çdo shërbimi të kërkuar siç janë ose mbase do të jenë të përshtatshme për qëllim të marrëveshjes. **Të përfshihen të gjitha, nivelet e defekteve, siguria e pajisjeve matëse, etj.**

Koment; Ky koment duhet të mbulohet nga kodet dhe standardet për furnizim që do të aprovohen nga ZRRE-ja. Sa i përket praktikës, Operatorët e Sistemit mund t'i bashkëngjisin pjesë përkatëse të kodeve të lartpërmendura kur ata i përgjigjen ndonjë aplikacioni të konsumatorëve.

7.4. (tani 8.5) Për qëllim të përcaktimit **dhe taksimit** të një përqindjeje të përshtatshme të kostove **ndaj një aplikanti do të varet nga kostot** që janë hasur direkt ose indirekt gjatë kryerjes së punëve sipas marrëveshjes për sigurimin e kyçjes ose ndryshimit të një kyçjeje ekzistuese, operatori i sistemit duhet të marrë parasysh **masën me të cilën:**

Komenti: I pranuar

7.4 (tani 8.5) a) përfitimi nga kyçja **do të jetë në dispozicion të të tjerëve**, shfrytëzuesve të tanishëm dhe/ose të ardhshëm të sistemit, palëve të treta **të cilat shërbehen nga operatori i sistemit**;

Komenti: I pranuar

7.4 (tani 8.5) b) operatori i sistemit **mund** të mbledhë përqindjen e këtyre kostove prej shfrytëzuesve të sistemit të tanishëm dhe të ardhshëm ose prej palëve të treta, **duke u bazuar në përfitimin e përmendur në paragrafin a)**;

Komenti: I pranuar

7.4 (tani 8.5) c) që tarifatat për kyçje **duhet të vilen mbi bazën e njehershme**, dhe duhet të paguhen përpara fillimit të punëve për kyçje **për ta bërë një kyçje të tillë të mundshme në saje të kërkesave buxhetore**

Komentit: Nuk pranohet. Ne e konsiderojmë si të panevojshëm.

7.5. (tani 8.6) Asnjë pagesë nuk do bëhet për përforcim të një rrjeti ekzistues nëse kërkesa për ngarkesë të re ose të shtuar nuk kalon (.3..) % të kapacitetit efektiv ekzistues në pikën përkatëse në rrjet; dhe përforcimi i kryer në më shumë se në një nivel të tensionit më lartë se tensioni i kyçjes. **(ku kërkohet zgjerim i kapacitetit të një kyçjeje, konsumatori do të i detyrohet të respektoj standardet e operatorit të sistemit të detajizuara në Metodologjinë e Taksave për Kyçje)**

Koment: Kuptimi i Këtij Rregulli është që asnjë konsumator të ri të mos i lejohet të përmirësoj ndonjë kyçje. Konsumatorët janë të obliguar të paguajnë për kyçje bazuar në Metodologjinë për Taksat dhe OS të themeloi, posedoi, mirëmbaj zëvendësoi etj.. Asetet për kyçje në të ardhmen duhet të jenë pjesë e Aseteve Bazë të Rregulluara (RAB) që me Metodologjinë e Tarifave konsiderohen të ndryshme nga pasuritë e blera nga kompania.

7.7. (tani 8.8) Në rast të vendosjes së kyçjes për një konsumator të kualifikuar **definicioni: 4.1.b** oferta dhe marrëveshja për kyçje mund të nxirret dhe të dorëzohet pa përfshirë furnizuesin. Konsumatori i privilegjuar në atë rast mund të nënshkruajë Marrëveshjen për Hyrje, e cila vendos detyrim për t'u përputhur me Rregullin e Tregut.

Përgjegjëje: Është dhen në Nenin 4.1b

8.1. (tani 9.1) Operatori i sistemit mund të refuzoj të kyçë një aplikant për kohësisht ose përherë vetëm nëse ajo kyçje është teknikisht dhe ekonomikisht jo e mundshme në përputhje me dispozitat e kodit të rrjetit dhe shpërndarjes ose kodeve tjera të aplikueshme. **(çfarë në lidhje me zhvillimin special dhe konsideratën ndaj zonave të diferencuara. Kjo të drejton ke fizibiliteti ekonomik – shiko 4.1. b)**

Përgjegjëje: Është dhënë më lartë.

9.1. (tani 10.1) Brenda periudhës kohore të specifikuar në ofertën për kyçje, aplikanti pranon ofertën duke i dërguar **furnizuesit** marrëveshjen e nënshkruar për kyçje sipas Shtojcës C, dhe paguan tarifatat përkatëse për kyçje **në përfitim të operatorëve të aplikueshëm të sistemit**

Komentit: I pranuar

9.3. (tani 10.3) Marrëveshja për kyçje duhet të:

e) **standardet minimale të sigurisë**

f) **kriteret minimale të sigurisë përfshirë kriteret në lidhje me vulosjen e pajisjeve matëse dhe mbylljen e vend-rrerthimit ku janë instaluar ndërprerësit, pajisjet matëse, transformatorët dhe qarqet matëse**

Koment: I pranuar për periudhën transitore në rast të aplikimit të dispozitave të këtij Rregulli para se të hyjnë në fuqi kodet teknike të parapara nga ligjet themelore. Një paragraf i ri do të shtohet si në vijim:

g) dispozitat e përshkruara sipas paragrafëve e) dhe f) do të aplikohen menjëherë sapo të hyjnë në fuqi kodet teknike të parashikuara në Ligjin mbi Energjinë Elektrike

10.4. (tani 11.4) **Kyçja e një konsumatori do të aktivizohet (kyçet) vetëm me udhëzimin e shkruar nga furnizuesi dhe dërguar te Operatorit i Sistemit, se është nënshkruar Marrëveshja për Furnizim dhe janë plotësuar të gjithë kriteret për furnizim.**

Koment: I pranuar

KAPITULLI 3 (tani 4) Shfrytëzimi i Sistemit

(Nenet 11, 12 & 13 (tani 12, 13 & 14) a janë të menduara vetëm për Furnizuesin?)

Përgjegjëje: Jo vetëm për furnizuesit por edhe për gjeneruesit dhe gjithashtu të gjithë shfrytëzuesit e rrjeteve të transimit dhe distribucionit.

14.1. (tani 15.2) Konsumatorëve u kërkohet një aplikacion për furnizim në rast se ata ndryshojnë furnizuesin. Në rastet kur konsumatorët nuk kërkojnë zgjerim të kapacitetit të kyçjes, **ata nuk kanë nevojë t'u përmbahen dispozitave të Neneve 6 dhe 7 të këtij Rregulli. Në rast se konsumatori nuk është në përputhje me kriteret komerciale minimale të sigurisë dhe mbrojtjes që janë përshkruar në Nenet 6, 7, 9 dhe 10 (tani 7, 8, 10 dhe 11) të këtij Rregulli, kyçja ekzistuese do të shkrycet në një datë të dakorduar që do t'i mundësojë konsumatorit të bëjë një kyçje të re alternative në përputhje me kriteret.**

Koment: I pranuar

15.1 (tani 16.1) Kontrata për furnizim do të bëhet **ngjashëm** si në Shtojcën E (tani C), e cila i nënshtrohet modifikimeve ose plotësimeve që mund të propozohen nga furnizuesi dhe të pranohen nga konsumatori

Koment: I pranuar

15.2. (tani 16.2) Kontrata për furnizim hyn **në fuqi dhe kyçja do të lidhet nga operatori i sistemit** brenda një periudhe kohore e cila nuk i tejkalon (5) ditë kalendarike prej datës së nënshkrimit nga furnizuesi dhe konsumatori, **pas së cilës do të vijojë njoftimi i pranimit të kyçjes nga operatori i sistemit. Ky i fundit do të vërtetohet në përputhshmërinë me kriteret e kyçjes.**

Koment: I pranuar

15.3. (tani 16.3) Konsumatorit **dhe operatorit të sistemit** do t'u komunikohet me shkrim data e fillimit të kontratës për furnizim. Përfaqësuesi i autorizuar i **operatorit të sistemit** do të bëjë një **lidhje të re, ose do të bëjë përmirësimin e lidhjes me anë të një udhëzimi me shkrim nga ana e furnizuesit.** Pozitat e njehsorëve **do të dakordohen nga përfaqësuesi i furnizuesit, operatori i sistemit dhe konsumatori.**

Koment: I pranuar

16.1. (tani 18.1) Çdo furnizues është i detyruar që të furnizojë me energji çdo konsumator që gjendet në zonën e mbuluar nga i licencuari për furnizim, dhe që është i kyçur në rrjet në përputhje me marrëveshjen për kyçje dhe në bazë të dispozitave të kontratës për furnizim, **dhe duke ju nënshtruar kriterëve të Nenet 6, 7, 9 dhe 10 (tani 7, 8, 10 dhe 11).**

Koment: I pranuar

16.2. (tani 18.2) I njëjti detyrim vlen për furnizimin e konsumatorëve të privilegjuar që, për çfarëdo arsyeje, nuk furnizohen më nga furnizuesit e përzgjedhur dhe duan të furnizohen nga furnizuesit publik në përputhje me Rregullin mbi Licencimin. **E drejta për të qene i privilegjuar kërkohet nëse bihet në pajtim me Nenet 6, 7, 9 dhe 10** (tani 7, 8, 10 dhe 11).

Komenti: I pranuar

17.2. (tani 19.2) Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet sipas konsumimit në periudhat paraprake krahasuese ose në përputhje me sasinë **e kalkular në përputhje me metodat e aprovuara nga ZRRE-ja si metodë e drejtë për të vlerësuar konsumin dhe kërkesën maksimale të furnizuar në periudhat përkatëse ku është e aplikueshme.**

Koment: Nuk pranohet por duhet të ndryshohet si më poshtë

Nëse konsumatori nuk lejon qasje për leximin e pajisjeve matëse edhe pas marrjes së njoftimit me shkrim, energjia e furnizuar do të faturohet sipas konsumimit në periudhat paraprake krahasuese siç përcaktohet në Nenin 19.5 në Rregullin mbi Shkycjen, ose në përputhje me sasisë që është rënë dakord të furnizohen gjatë periudhave përkatëse, të cilat nuk mund të jenë më pak se sasi të parashikuara në Nenin përkatës.

18.1. (tani 19.2) Furnizuesi (ose operatori i sistemit) nëse ka ndonjë marrëveshje **(Konflikt me 4.3.f?)** ndërmjet operatorit të sistemit dhe furnizuesit, është i obliguar që të siguroj lexim të rregullt dhe korrekt të njehsorëve, në përputhje me Kodin e Matjes.

Përgjigje: Me qëllim të mënjanim të konfliktit me Nenin 4.3 është riformuluar ashtu siç është mëposhtë

“Operatori i sistemit mund t’ia besojë leximin e njehsorëve furnizuesve ose ndonjë kontraktuesi tjetër. Në këtë rast, entiteti i kontraktuar për leximin e njehsorëve, është i detyruar të sigurojë lexim të rregullt dhe të saktë të njehsorëve, në përputhje me Kodin e Matjes.”

18.2. (tani 20.2) Pas kërkesës së konsumatorëve personi që i referohet Neni 18.1, është i obliguar të sigurojë atë me çfarëdo informate në lidhje me rezultatet e leximit të njehsorëve.

Vërejtje: A është qëllim që çdo lexim i njehsorëve të konsumatorëve të publikohet në ueb-faqe.

Koment: Do të jetë shumë e dobishme.

19.3. (tani 20.3) **Operatori i Sistemit është i detyruar të siguroj çdo përfundim në lidhje me saktësinë e njehsorëve të testuar nga furnizuesi për të korrigjuar humbjet komerciale ku është e aplikueshme , në pajtim me vendimin e ZRRE-së për humbjet komerciale.**

Koment: I pranuar me ndryshimet si në vijim

“Operatori i sistemit do të jetë i detyruar t’i sigurojë furnizuesve çdo përfundim në lidhje me saktësinë e njehsorëve të testuar, që nëse është e aplikueshme të bëjë reklamimin e humbjeve komerciale, në përputhje me parimet e këtij Rregulli dhe me Rregullin mbi Shkycjen dhe Metodologjinë e paraqitur nga Operatori i Sistemit dhe aprovuar nga ZRRE-ja.”

20.1. (tani 22.1) Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e konsumuar **dhe për taksat të tjera**, në përputhje me llojin e duhur të tarifës të **dakorduara** me konsumatorin

Komenti: I pranuar

20.3. (tani 22.3) Në rast të pasaktësive në lexim të njehsorëve, që ka rezultuar me faturim jo të saktë, furnizuesi duhet të bëjë të gjitha rregullimet e nevojshme në faturën vijuese. **. Vetëm ky lloj korrigjimi duhet të jetë në përputhje me Vendimin e ZRRE-së për Humbjet**

Komerciale dhe konsumatorëve do t'u jepet shpjegim i plotë për bazat dhe përmasën e korigjimit.

Koment: I pranuar me përmbajtje si në vijim.

“Në rast të pasaktësive në lexim të njehsorëve, që ka rezultuar me faturim jo të saktë, furnizuesi duhet të bëjë të gjitha rregullimet e nevojshme në faturën vijuese. Ky korigjim duhet të jetë në përputhje me Nenin 19.2 dhe konsumatorëve do t'u jepet shpjegim i plotë për bazat dhe përmasën e korigjimit”.

20.4. (tani 22.4) Faturat dërgohen në adresën e konsumatorit që është specifikuar në kontratën për furnizim. Nëse nuk është specifikuar adresa ose është specifikuar në mënyrë të pasaktë ose të paplotë, ose nëse konsumatori nuk gjendet më në adresën e specifikuar, furnizuesi do ta bëjë dërgesën në vendndodhjen fizike ku ka ndodhur konsumimi i energjisë. Nëse konsumatori **vazhdon me mos-pagesë, sipas Kontratës për Furnizim me kërkesë të furnizuesit operatorit i sistemit do të shkyçë vendin e konsumit nga rrjeti, në përputhje me Rregullin mbi Shkyçje që është aprovuar nga ZRRE-ja.**

Komente: Është pranuar vetëm ndryshimi i kërkuar për fjalë në vend të “Rregulla për Shkyçje e ZRRE-së” do të jetë “Rregulla për Shkyçje e aprovuar nga ZRRe-ja”

20.6. (tani 22.6) Faturat mund të ndajnë taksat për energjinë e konsumuar **dhe kërkesën maksimale** prej të gjitha pagesave tjera, duke përfshirë pagesat për shfrytëzim të rrjetit. Furnizuesi duhet të paraqesë një formë standarde dhe përmbajtje standarde të faturave të Bordi i ZRRE-së për rishikim dhe aprovim para se të dërgohen te konsumatorët.

Koment: Nuk është pranuar pasi që ne nuk e dimë se a do të jetë kërkesa maksimale për të gjithë konsumatorët pjesë e tarifave dhe formulimi i tanishëm nuk do të parandaloi që të konsiderohet nëse taksa për kërkesë nevojitet për të gjithë konsumatorët.

21.2. (tani 23.2) Depozitimi i Garancisë përbëhet nga një garanci e përshtatshme e cila mbulon taksat e ardhshme për furnizimin me energji dhe përbëhet nga një e gjashta e vlerës së faturimit të parashikuar për 12 muaj sipas tarifave që janë në fuqi në atë periudhë. **(fatura e vlerësuar 2 mujore)**

Koment: I pranuar dhe ky Nen do të ketë përmbajtjen si në vijim.

“Depozita e garancisë duhet të mbulojë taksat e ardhshme të parashikuara për një periudhë prej dy muajsh”.

21.3. (tani 23.3) Depozitimet e garancisë duhet të paguhen me para në dorë ose përmes xhironlogarisë bankare **para hyrjes në marrëveshjen për furnizim.**

Koment: Nuk është pranuar pasi që depozita e garancës duhet të kërkohet nga konsumatorët që janë të parregullt në pagesë.

22.2. (tani 24.2) Në rast të çfarëdo pagese që i bëhet operatorit të sistemit, konsumatorit duhet t'i lëshojë një dëftesë nga furnizuesi. Marrësi i pagesës do të mbajë një regjistër për të paktën 3 vjet, në lidhje me pagesat, informacionet mbi pagesat dhe shënimet në lidhje me arsyen e pagesës dhe prej kujt është bërë pagesa.

Koment: I pranuar

22.4. (tani 24.4) Procedura do të përmbajë periudhën prej datës së dorëzimit të faturës gjer me datën e afatit të fundit të pagesës, si dhe periudhën pas afatit të lejuar para se të aplikohet kamata për mos pagesë sipas **Nenit 25. (30 ditë për KEK).**

22.6. (tani 24.6) Periudha e lejuar pas afatit të fundit kohor para aplikimit të çfarëdo kamate ose interesi nuk do të jetë më e gjatë se njëzet (20) **4? ditë** prej datës së kalimit të afatit të fundit për pagesë. **(për KEK-un është planifikuar të jetë 30 ditë)**

Koment: Është pranuar dhe do të jetë 30 ditë.

Neni 25 (tani 27) Regjistrimet në lidhje me Kontratat për Furnizim

Furnizuesit janë të detyruar që të mbajnë regjistra me informacionet përkatëse të: **(Jo Rrjeti)**

Përgjegjëje: Jo domosdoshmërisht shënimet të jenë të ndara për konsumatorët e privilegjuar por Marrëveshjet për Kyçe në mes të Furnizuesit dhe Operatorëve të sistemit mund të përcaktojnë dhe ti qasen kësaj çështje. Qëllimi i këtij rregulli është të definoi obligimet kontraktuese në mes të Konsumatorit dhe Furnizuesit dhe Furnizuesit dhe Operatorëve të Sistemit.

25. (tani 27) a) marrëveshjeve të nënshkruara për kyçe për konsumatorët sa herë që kërkohet të kenë një marrëveshje **përveç** kontratës për furnizim;

25. (tani 27) c) aplikacionet për modifikim (**përmirësimin të kapacitetit ose ndryshimit të grupit tarifor**) të kontratave për furnizim;

Koment: I pranuar

e) (tani 27) faturimin, ndërprerjet e programuara dhe aksidentale në furnizim dhe përshtatja me kërkesat për kualitet **(ku është e përshtatshme)**

Koment: Nuk është pranuar. Derogimi do të definohet nga ZRRE-ja nëse një heqje e tillë kërkohet nga Furnizuesi respektivisht Operatori i Sistemit

26.5. (tani 28.5) Nëse fillimi i konsumit të paautorizuar, korruptimi ose vjedhja nuk mund të përcaktohet, do të supozohet që konsumi i paautorizuar ka zgjatur 12 muaj që nga dita që konsumatori ka nënshkruar kontratën për furnizim për konsumatorët familjar, përderisa 24 muaj për konsumatorët jo familjar, ose ditën e inspektimit të fundit **gjatë të cilit instalimi ka qenë në rregull**

Koment: I pranuar

26.7. (tani 28.7) Furnizuesi duhet të paraqesë për shqyrtim dhe aprovim të ZRRE-së procedurat për identifikim dhe përgjigjen ndaj vjedhjes prej konsumatorit të paregjistruar. Procedurat duhet të paku të përfshijnë raportimin e vjedhjes, identifikimin e konsumatorit të paautorizuar, përpjekjet e parashikuara për llogaritje dhe arkëtim të pagesave për konsumim, dhe opsionet potenciale Ligjore. **(vetëm ti dorëzoi te ZRRE-ja)**

Përgjigje: Pa koment, ky koment do të fshihet.

30.1. (tani 32.1) Brenda periudhës tre (3) mujore pas miratimit të kësaj Rregulle, furnizuesi publik në vend të konsumatorit duhet të paraqesë te operatorët e sistemit të bartjes dhe shpërndarjes një aplikacion për kyçe të të gjithë konsumatorëve ekzistues.. **(300 000 aplikuesë? Keni vëmendjen se disa konsumatorë ekzistues janë ‘përkohësisht’, disa nuk janë në gjendje të mirë financiare, informata komplete për disa të tjerë janë të panjohura si dhe disa të tjerë nuk janë konsumatorë. Kujdes të veçantë duhet të ketë për përjashtimet e konsumatorëve social dhe politik.**

Koment: Nuk pranohet. Aplikacioni mund të përmbajë çfarëdo problemi në lidhje me konsumatorët siç janë

- **Konsumatorët në gjendje të mirë në aspektin ligjor dhe teknik**
- **Konsumatorët në gjendje të mirë vetëm në aspektin ligjor dhe**
- **Konsumatorët ilegal (mbase mund të vlerësohen)**

Marrëveshja për Kyçe duhet të adresoi përgjegjësitë e palëve kontraktuese për të zgjidhur mardhëniet me konsumatorët në afat të caktuar. Deri në aprovimin e këtij Rregulli palët kontraktuese kanë në dispozicion 6 (gjashtë) muaj për të vendosur këto marrëveshje. ZRRE-ja është e vetëdijshme për situatën aktuale por qëllimi i këtij Rregulli dhe Rregullave tjera është që qartë të

adresi të gjitha problemet e konsumatorëve në lidhje me mos pagesën dhe ti sjellë ata në gjendje të mirë pagese.

30.8. (tani 32.8) Brenda njëqindnjëzet ditësh (120) **(4 mujore)** kalendarike pas adoptimit të këtij Rregulli, operatori i sistemit duhet që t'i dorëzojë ZRRE-së format standarde për këto marrëveshje:

Koment: Pranohet dhe do të jetë pjesë e afateve tjera të precizuara në disa prej Neneve.

30.8. (tani 32.8) c) Marrëveshjen për kyçjen në shpërndarës – **kjo lejon 2 muaj për furnizuesin ti përfundoj marrëveshjet për kyçje me operatorët e sistemit sipas 30.2**

Koment: Nuk pranohet sepse DSO mund të zhvillojë këto parime të marrëveshjes ndaras dhe mos të vonoj në afatin e caktuar për nënshkrim me furnizuesin.

Ky aplikacion i nënshtrohet kritereve të:

- 1. Ligjit për Energjinë Elektrike**
- 2. Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji**

Komenti: Pranohet

Shtojca A: Aplikacioni për Kyçje dhe Furnizim

1. Konsumatorët e Amvisërisë / **Shtëpiak**

Komenti: Nuk pranohet sepse termet janë përdorur ashtu si janë në Ligjet themelore.

Për (furnizuesin) Numri Regjistruar: _____ (Konsumatorët nuk e kanë këtë)

3. Përshkrimi i objektit për të cilin kërkohet kyçja:

(e) Pronari (ngjashëm si në 10.) _____

4. Shënimet teknike:

Shfrytëzimi i tokës nga objektet që do të kyçen: Agrikulturë, Amvisnisë dhe Komercial

(a) Kapaciteti ekzistues i aprovuar i lokacioneve (nëse është e mundshme). Kapaciteti i ri kërkohet me këtë aplikacion.

Kapaciteti i Instaluar _____ kWatts

(c) Përshkrimi i Lokacionit:

Të tjera (për kalkulim të tarifës paushallë nëse kërkohet) _____ m²

Komenti: Pranohet

5. Kategori tarifore e zgjedhur _____

a) kategoritë në disponim : 4/01 dhe 4/02. Tarifat e aprovuara të energjisë elektrike për çdo njërin janë të publikuara në ueb sitin e ZRRE-së.

b) standardi i zgjedhur i kyçjes:

40 A një fazore (9 kVA)

40 A 3 fazore (30 kVA)

60 A 3 fazore (45 kVA)

Kostot e kyçjes të paguara te operatorët e sistemit për konstruktim të kyçjes ose kreditimi i konsumatorit për konstruktim të kyçjes dhe taksa për kapacitet janë të pagueshme sipas Metodologjisë së Taksave për Kyçje në Nenin 5.1 të Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me.

c) Shiko aplikimin për Jo - Shtëpiak.

Komenti: Nuk pranohet sepse kategoritë tarifore janë në zhvillim e sipër dhe metodologjia e taksave për kyçje duhet të zhvillohet poashtu. Format në këtë Rregull përmbajnë kërkesat aktuale nga ZRRE-. Furnizuesi mund të zhvillojë më tej format të cilat mbase mund të jenë në përputhje me regjistrat e tyre dhe procedurat e vendosura.. Në çfarëdo rasti çdo njëri furnizuesi dhe DSO ose TSO duhet të paraqesin te ZRRE-ja për aprovim format e zhvilluara nga vetë ata për aprovim.

6. Borxhet e vonuara:

(b) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike për objektin për të cilin është aplikuar kyçja:

Po/Jo (Nëse përgjigja është 'Po' ju lutem jepni detajet) (shiko 10. b në fund të aplikacioneve për konsumatorë Jo – shtëpiak).

8. Dokumentet e bashkangjitura të paraqitura:

(a) Dëshmi e dokumentuar e pronësisë / autorizim për shfrytëzim të pronës.

Përfshirë rastet tipike se çfarë dokumente do të ishin të pranueshme.

(e) Dëftesa zyrtare e KEK-ut për pagesë të taksës për aplikim.

Koment: Pranohet por vetëm inicialet KEK duhet të fshihen.

10. Nënshkrimi dhe pronësia e lokacionit ku është sugjeruar në 1.g që aplikuesi është pronar i ri:

Emri:

Nënshkrimi:

Data:

Vendi:

Komenti: Pranohet

2)Konsumatori jo-shtëpiak (shiko shtëpiak)

4. Shënimet teknike:

Kapaciteti i kërkuar:

(a) _____ kVA

(b) Përshkrimi i shfrytëzimit të pronës dhe sipërfaqes së hapësirës që do të furnizohet nga kjo kyçje.

Komenti: Pranohet

5. Kategoria tarifore e zgjedhur

a) Kategoritë tarifore në disponim: 7/01, 7/02/, 6/06, 1/1, '1/2, 1/3. Tarifat e aprovuara të energjisë elektrike për çdo njëerën janë të publikuara në ueb sitin e ZRRE-së.

b) Kostot e kyçjes dhe tarifat për kapacitet do të paguhen (shiko 5. b) në shtëpiak).

c) Sinjalet se nëse konsumatori do të konstrukttoj kyçjen ose ndonjë pjesë të saj apo KEK-u do të jetë entiteti që pritet të menaxhojë konstruktimin.

Komenti: Nuk pranohet shiko sqarimin në 5 aplikacionet për amvisini

Me këtë kërkoj/ nuk kërkoj konkludim të marrëveshjes plotësuese që siguron kushte specifike në lidhje me mirëmbajtjen e kyçjes, si vijon:

Data më të cilën kyçja / zgjerimi i kapacitetit të kyçjes kërkohet. Koha maksimale e lejuar sipas Rregullit KPFE, Nenet 4.3 dhe 7.6 për tu arritur një marrëveshje përfshirë datën e kyçjes është 90 ditë kalendarik – 3 muaj.

Koment: Pranohet

11. Dokumentet e bashkangjitura:

(f) Dëftesa zyrtare e KEK-ut për pagesën së taksës për aplikim

Koment: Pranohet por vetëm inicialet KEK duhet të fshihen.

Aneksi B: Oferta për kyçje (paraqitur te furnizuesi)

2. Zgjidhja e propozuar teknike:

- ii. Përshkrimi i rregullimeve dhe pajisjeve të domosdoshme teknike që duhet të përdoren për kyçje:
Niveli i ngarkesës maksimale të ndërprerësve dhe përçuesve.

Komenti: Kjo do të jetë pjesë e përshkrimit teknik .

- iv. Tensioni i lejuar, kapaciteti maksimal dhe energjia: - **(Ku është qëllimi? A duhet që vetëm kërkesa maksimale të shprehet në Amp. (në tensionin e aplikueshme) Ct's dhe CB duhet të vendosët në normë në kapacitetin e aprovuar.**

Koment: Pranohet

3. Mbrojtja & ndërprerësit dhe 4. Kriteret e Përgjithshme

Koment: Matja dhe mbyllja do të jenë pjesë të Kodeve të Matjes që kjo Rregull I referohet edhe pas aprovimit të këtyre kodeve dhe ndryshimeve tjera përkatëse që furnizuesi ose operatori i sistemit e shohin si të nevojshme dhe që mund të pranohet nga ZRRE-ja.

5. Çështjet e ndërlidhura me shfrytëzim të rrjetit:

- i. **Tarifa e rekomanduar:** _____
- ii. Metoda dhe afatet për pagesë të kostove dhe taksave për shfrytëzimin e rrjetit (**kreditë e dhëna për kostot që mbulohen nga konsumatori**) :

Koment: Pranohet

Komentet nga Z. Ali Hoxha:

Drafti në fjalë i propozuar nga ana e juaj, versioni në gjuhën shqipe, ka gabime të numërta gjuhësore, përkthim bukval nga Gjuha Angleze, kohët e foljeve janë të

ngatërruara; shpesh e kaluara përdoret në të ardhshmen, shpesh përdoren terme jo adekuate, me një fjalë len përshtypjen se është tekst i pa lektuar. Ja disa nga vërejtjet tona:

Neni 1.1. Nocioni; “Konsumatorët përfundimtarë”, të zëvendësohet me Nocionin.”Konsumatorë fundorë’,

Komenti: Pranohet

Neni 1.2.h) Nocioni; “Energjia e pafurnizuar”, të zëvendësohet me Nocionin; “Energjia e pa dërguar”,

Komenti: Pranohet

Neni 4.3. Operatori i sistemit duhet të përcaktohet: TSO-ja, apo DSO-ja,

Komenti: Nuk pranohet sepse provizionet e këtij rregulli vlejnë për të dy operatorët

Neni 7.5. Përqindja e pa qartë “.3.” ?,

Neni 25. Fjalja hyrëse e këtij neni nuk lidhet mirë me fjalitë pasuese. Ka gabime në të shprehur dhe në të shkruar.

Komenti: Pranohet dhe në vend mbajnë duhet të duhet të regjistrojnë

Neni 26.1. Nuk thuren fjalët mirë mes veti . Fjali e pa kuptimtë. Veprimi ndodhë në kohë të shkuar e jo në kohë të ardhshme.

Komenti: Pranohet

Neni 26.5. Konsideroj se më drejtë është që të përdoret shprehja; “Konsumatorë të amvisnisë dhe ata komercial”, në vend të shprehjes “Konsumatorë familjarë dhe ata jo familjarë”.

Komenti: Pranohet

Komentet nga DMK Petrit Pepaj

Kapitulli 6 Matja, Faturimi dhe Pagesat, nevojiten dy paragrafë shtesë

- Periudha e leximit të njehsorëve duhet të specifikohet në faturën e konsumatorëve: kjo periudhë e leximit nuk duhet të tejkaloi datën 5 të çdo muaji të ardhshëm.

Komenti: Nuk pranohet, për arsye se janë disa mënyra të leximit për çdo periudhë faturimi, lexim ditor, leximi me periudhë të gjatë rregullimi p.sh. 6 mujor etj.

- furnizuesi (ose operatori i sistemit) është i detyruar të vëzhgoi periudhën e leximit.

Komenti: Nuk pranohet. Për derisa periudhat e leximit janë të ndryshueshme dhe sipas këtij Rregulli nuk kërkohet që me përpikëri të përcaktohet ndonjë metodologji e lexim kështuqë ky koment nuk mund të pranohet.

- Neni 20, paragrafi 20.3 është i paqartë për mua dhe mendoj se është më mirë të shkruhet ndryshe si në vijim:

Kur konsumatori dyshon në saktësinë e leximit të njehsorit, ose regjistrimin e njehsorit, ai ka të drejtë të ankohet te furnizuesi dhe ky i fundit duhet t'i bëjë të gjitha përmirësimet e nevojshme në faturën e ardhshme ose të marrë masa për saktësi të leximit të njehsorit.

Komenti: Nuk pranohet, Dispozita 20.3 i referohet vetëm vendosjes së gabuar të pozitës së njehsorëve. Në rast të çfarëdo mosmarrëveshje bazuar në dyshimin e konsumatorit, Rregulli për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve e rregullon atë

Komentet nga Z. Astrit Saraqini ENQG:

1.3. Gazi Natyror dhe të gjitha çështjet në lidhje me **furnizimin dhe shërbimet e gazit natyror** nuk janë të mbuluara nga ky Rregull.

Komenti: I pranuar

2.1. Ky Rregull përfshin dispozitat dhe **Shtojcat** që janë pjesë integrale të tij.

Komenti: I pranuar

Neni 4 Parimet e Përgjithshme, të Drejtat dhe Detyrimet

4.1. Në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe detyrimin që të:

f) paguajë për energjinë e konsumuar dhe për shfrytëzim të sistemit, sipas kontratës me Furnizuesin e Energjisë dhe tarifata e **rregulluara** dhe/ose tarifata e rrjetit të aprovuara nga ZRRE-ja.

Komenti: I pranuar

4.2. Furnizuesi duhet të:

d) hartojë **aplikacionet për kyçje dhe furnizim**, ofertat, kontratat, faturat, deklaratat dhe njoftimet që u adresohen konsumatorëve;

Komenti: Nuk pranohet

4.3. Operatori i sistemit duhet të:

l) zhvillojë **dhe dorëzojë për shqyrtim dhe aprovim në ZRRE**, Metodologjinë e Taksave për Kyçje, përfshirë format e nevojshme për kyçjen dhe shfrytëzimin e sistemit, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Rregull dhe rregulla të tjerë të nxjerrë nga ZRRE-ja;

Komenti: I pranuar

4.4. Çdo Furnizues dhe operator i sistemit është i detyruar që në pajtim me këtë Rregull të zhvillojë politika në lidhje me kushtet për kyçjen në **sistem** dhe furnizimin me **energji**. Të gjitha këto politika duhet të sigurojnë procedurë transparente dhe jo diskriminuese dhe t'i paraqiten ZRRE-së për rishikim dhe aprovim paraprakisht para hyrjes në fuqi. Këto politika duhet bërë publikisht duke qenë në dispozicion në faqen

zyrtare elektronike, shtypin ditor, njoftime, raporte publike dhe çdo mënyrë tjetër që duket e përshtatshme.

Komenti: I pranuar

KAPITULLI 2 Kyçja në sistem Neni 5 Kushtet e Përgjithshme të Kyçjes

5.1 Çdo konsumatorë i vendosur në zonën e shërbimit që mbulohet nga operatori i sistemit do të ketë të drejtë, kur është teknikisht dhe ekonomikisht e realizueshme, që të kyçë pajisjet dhe objektet e tij në rrjetin e transmisionit ose distribucionit, nëse ky konsumatorë i plotëson kushtet si në vijim:

- a) Për energji elektrike – Ka në pronësi ose ka autorizim për përdorim të pajisjeve elektrike dhe instalimeve të brendshme, që plotësojnë kërkesat teknike, të punës dhe të sigurisë
- b) Për ngrohje qendrore – Ka në pronësi ose ka autorizim për të përdorur rrjetin e brendshëm sekondar duke e dërguar ngrohjen te përdoruesi i fundit, që plotëson kushtet teknike, të punës dhe të
- c) Plotëson kushtet për kyçje në rrjetin e transmisionit ose distribucionit siç parashihet në këtë Rregull, Kodet Teknike dhe rregullat tjera të aplikueshme dhe marrëveshjen për kyçje përkatëse.

Komenti: Nuk pranohet për arsye se këto dispozita në të shumtën e rasteve kanë të bëjnë me kriteret e dhënies së licencës ndërsa qëllimi i këtij kapitulli është që të sqarojë parimet kryesore të metodologjisë së taksave.

5.1. (tani 6.1) Operatorët e sistemit duhet të zhvillojnë metodologjinë e taksave dhe procedurat për kyçje në përputhje të plotë me rregullën për "Metodologjinë e Tarifave" të aprovuar nga ZRRE-ja, e që përfshin taksat për:

- h) aktivizim të kyçjes jashtë funksionale në rastet e ndërprerjeve të punës së centralit **energjetikë** pasi që arsyet e ndërprerjes zhduken.

Komenti: I pranuar

7.3. (tani 8.3) Përveç kriterëve të përcaktuar në Nenin 7.2, në rastet e kyçjes në rrjetin e shpërndarjes së ngrohjes, oferta për kyçje duhet të përmbajë gjithashtu kushtet teknike të kyçjes të cilat i bashkëngjiten ofertës dhe të cilat duhet të përcaktojnë:

- a) vendndodhjen e nënstacionit brenda ndërtesës së konsumatorit, duke specifikuar pikën e kyçjes dhe mënyrën e kyçjes në tubacionin e furnizimit;
- b) kufijtë e pronësisë së instalimit brenda nënstacionit;
- c) rrjedha e skicuar e transportuesit të ngrohjes dhe tabelat e rregullimit;
- d) kriteret që kanë të bëjnë me nënstacionin për sa i përket termave të kriterëve specifike të ndërtimit për nënstacionet, dhe specifikimi i pajisjeve të nënstacionit dhe vendndodhjet e valvuleve për kontrollin e rrjedhjes, njehsori i ngrohjes dhe njehsori për ujin sanitar që furnizon sistemin dytësor.
- e) Kriteret në lidhje me instalimin e brendshëm të ngrohjes

Komenti: Pranohet dhe më tej do të jetë në Nenin 8.3. Neni aktual 8.3 do të bëhet 8.4.

7.6. (tani 8.7) Oferta për kyçje duhet të lëshohet dhe dërgohet te konsumatori përmes furnizuesit brenda kohës, duke mos tejkaluar:

c) **tridhjetë (30) ditë kalendarike prej ditës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje në rrjetin e shpërndarjes së ngrohjes**

Komenti: I pranuar

9.1. (tani 10.1) Brenda periudhës kohore të specifikuar në ofertën për kyçje, aplikanti pranon ofertën duke i dërguar furnizuesit **draft** marrëveshjen e nënshkruar për kyçje sipas C, dhe paguan tarifën përkatëse për kyçje në përfitim të operatorëve të aplikueshëm të sistemit.

Komenti: I pranuar

KAPITULLI 4 (tani 2) Furnizimi

Neni 5 Parimet e Përgjithshme Të Furnizimit me Ndrohje

14.1. (tani 5.1) Të gjithë konsumatorët fundorë do të kenë të drejtën, që nëse është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur, të gëzojnë shërbimin universal të furnizimit me ndrohje prej rrjeteve të ndërmarrjeve të energjisë të cilat kryejnë shërbime publike në përputhje me këtë Rregull.

14.2. (tani 5.2) Për momentin, furnizimi me ndrohje përdoret për ndrohjen e hapësirave, por mbase do të mund të përdoret edhe për furnizim me ujë të nxehtë sanitar.

14.3. (tani 5.3) Furnizimi i ndrohjes për qëllime të ndrohjes së hapësirave, do të kryhet gjatë sezonit të ndrohjes i cili zakonisht zgjat prej 15 Tetorit deri në 15 Prill; në varësi të kushteve klimatike, sezoni i ndrohjes mund të shkurtohet ose zgjatet (furnizim i jashtëzakonshëm me ndrohje)

14.4. (tani 5.4) Sezoni i ndrohjes mund të zgjatet maksimalisht prej 1 Tetorit deri në 30 Prill, duke aplikuar furnizimin e jashtëzakonshëm me ndrohje sipas kushteve në vijim:

a) furnizimi i jashtëzakonshëm me ndrohje do të aplikohet në rast se sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ndrohtores temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ndrohjes qendrore, për tre ditë rresht regjistrohet poshtë 12 °C;

b) furnizimi i jashtëzakonshëm me ndrohje do të përfundojë kur sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ndrohtores temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ndrohjes qendrore, për tre ditë rresht regjistrohet 12 °C ose është më e lartë.

14.5. (tani 5.5) Sezoni i ndrohjes do të shkurtohet duke ndaluar furnizimin me ndrohje vetëm në rastet kur sipas të dhënave të shërbimeve meteorologjike ose sipas të dhënave prej ndrohtores temperatura e jashtme e matur në orën 21:00 në zonën e mbuluar prej ndërmarrjes së ndrohjes qendrore, për dy ditë rresht regjistrohet 12 °C, ose është më e lartë, dhe kur parashikimet e motit prej shërbimeve meteorologjike parashohin se temperatura për tre ditët në vijim do të jenë 12 °C më të larta.

Komenti: I pranuar bazuar në komentet e paraqitura më lartë duhet krijuar kapitullin e ri me radhitje 2, kapitulli ekzistues kalon në kapitullin 3. Termi“ energji“ i përdorur në komente do të zëvendësohet me termin “ngrohje“.

14.5. (tani 15.6) Nëse një aplikuesi i refuzohet shërbimi, aplikuesi mund të fillojë zgjidhjen e **mosmarrëveshjes** në përputhje me Rregullin për Zgjidhjen e **Mosmarrëveshjeve**. Nëse refuzimi vjen nga operatori i sistemit, furnizuesi mund të inicioj zgjedhje të mosmarrëveshjes në vend të konsumatorit

Komenti: I pranuar

15.5. (tani 17.1) Në ngrohjen qendrore, konsumatori - pala kontraktuese konsiderohet pronari ose shfrytëzuesi i autorizuar i ndërtesës së pajisur me nënstacion dhe me rrjetë dytësor të ngrohjes së brendshme.

15.6. (tani 17.2) Në rast të ndërtesave me shumë kate të cilat përbëhen nga apartamente të shumta në pronësi individësh të cilët janë shfrytëzuesit fundorë të ngrohjes, konsumatori- pala kontraktuese e furnizuesit – do të konsiderohet një entitet ligjor që përmbush detyrat e veta të administrimit shtëpiak (p.sh. administrator, shoqata banesore, etj.) i cili do të krijohet në të ardhmen.

15.7. (tani 17.3) Deri në krijimin e administratës banesore në ndërtesat shumëkatëshe, çdo pronar i apartamenteve do të konsiderohet si një konsumator- palë kontraktuese e furnizuesit.

Komenti: Pranohet dhe do të inkorporohet në Rregull si Nen i ri, 17 i titulluar "Marrëdhëniet Kontraktuese në rastet e Furnizimit me Ngrrohje"

19.2. (tani 21.1) Në rastet kur rezultatet testuese tregojnë funksionim jo të rregullt të njehsorit, që nuk është shkaktuar si rezultat i ngacmimit të njehsorit, operatori i sistemit është i detyruar që të kalibrojë ose zëvendësoj njehsorin në rast se ka nevojë.

Komenti: Nuk pranohet. Veç se është përfshirë

19.3. (tani 21.2) Në rast se funksioni i furnizuesit dhe operatorit të sistemit kryhet nga i njëjti entitet, ky i fundit është i detyruar të testojë njehsorin sipas kërkesës së konsumatorit.

Komenti: I pranuar

20.1. (tani 22.1) Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e konsumuar, në përputhje me llojin e duhur të tarifës të dakorduar me konsumatorin (nëse është e aplikueshme)..

Komenti: I pranuar

22.1. (tani 24.1) Pagesa e faturave dhe depozita garantuese duhet të kryhet me para në dorë në qendrën e përcaktuar të furnizuesit në çdo ditë pune, ose **nëpërmes xhiorlogarisë bankare të furnizuesit ose me çfarëdo mënyre të pagesës të specifikuar në Kontratën për Furnizim.**

Komenti: Nuk pranohet. Kuptimi i pagesës me para në dorë nënkupton edhe pagesën nëpërmes xhiorlogarisë bankare.

23.2. (tani 25.2) Në rast të mos pagesës **brenda periudhës së lejuar, siç përcaktohet në Nenin 22.6** (tani 24.6), konsumatori është i detyruar të paguajë kamatë për shumën e borxhit në normë prej XX% për muaj, pa paragjykim ndaj të drejtës së furnizuesit për të vënë gjoba për mospagim, sipas çdo klauzole të gjobave të përfshira në kontratën për furnizim.

Komenti: I pranuar

30.3. (tani 32.3) Brenda periudhës kohore **gjashtë (6)** mujore pas miratimit të kësaj Rregulle, furnizuesi i ngrohjes do të nënshkruaj me të gjithë konsumatorët kontratën për furnizim

Komenti: I pranuar

30.5. (tani 32.5) Brenda periudhës kohore të vendosur në Nenin 30.1 (tani 32.1) furnizuesi duhet të paraqesë raportin te ZRRE në pajtueshmëri me Nenin 38.3 ose Ligjin për Energjinë Elektrike

Përgjigje: Ky Rregull përcakton kriteret e vendosjes së parimeve të kyçjes në rrjet të operatorit të sistemit të çdo shfrytëzuesi si dhe shfrytëzimin e atij sistemi. Kyçja dhe shfrytëzimi i sistemit duhet të ndahen me marrëveshje që do të thotë vendosjen e relacioneve komerciale.

Shtojca A: Aplikacioni për Kyçje dhe Furnizim

1. Konsumatorët e Amvisërisë

4. Shënimet teknike për ngrohje:

c) Përshkrimi i pronës:

Lokacioni i nënstacionit _____ m² (për ngrohje qendrore)

d) Lloji dhe parametrat e sistemit sekondar të konsumatorit / instalimet e brendshme të ngrohjes.

Koment: Pranohet dhe do të konsiderohet për ngrohje

6. **Borxhet e vonuara:**

(a) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike / **ngrohëse** në zonën e veprimit të të licencuarit në emër të aplikantit:

(b) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike / **ngrohëse** për objektin për të cilin është aplikuar kyçja :

8. **Dokumentet e bashkangjitura të paraqitura:**

(e) Skica e planit të nënstacionit dhe instalimeve të brendshme të ngrohjes (për ngrohje qendrore)

Koment: Pranohet dhe do të konsiderohet për ngrohje

Konsumatori jo-shtëpiak

4. **Shënimet teknike:**

(a) Kapaciteti i instaluar _____ kWatts (ngrohje qendrore)

(e) Lloji dhe parametrat e sistemit sekondar të konsumatorit / instalimet e brendshme të ngrohjes (për ngrohje qendrore).

Koment: Pranohet dhe do të konsiderohet për ngrohje

5. **Kategoria tarifore e zgjedhur (nëse është e aplikueshme)**

Koment: Pranohet dhe do të konsiderohet për ngrohje

6. **Borxhet e vonuara:**

(a) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike / **ngrohëse** në zonën e veprimit të të licencuarit në emër të aplikantit:

(b) Çdo borxh i vonuar për energji elektrike / **ngrohëse** për objektin për të cilin është aplikuar kyçja :

Koment: Pranohet dhe do të konsiderohet për ngrohje

11. **Dokumentet e bashkangjitura:**

(g) Skica e planit të nënstacionit dhe instalimeve të brendshme të ngrohjes (për ngrohje qendrore)

Koment: Pranohet dhe do të konsiderohet për ngrohje

Komentet nga Znj. Merita Kostari HLD:

1) Në Nenin 2.1 përdoret termi “Marrëveshje për Furnizim” derisa paragrafi d) përdorë “Kontratë për Furnizim“. Për shkak të konsistencës ndrysho termin “marrëveshje” në paragrafin a) me “kontratë”. Nëse është Marrëveshje për Kyçje nuk ka nevojë për

Komenti: Pranohet dhe do të jetë Marrëveshja për Kyçjet

2) Neni 2.1 g), derisa shkyçja mbulohet prej Rregullit për Shkyçjen, ju sugjerojë që të fshihet. Ky Rregull përmban disa elemente por procedura është e mbuluar nga rregulli për Shkyçjet.

Komenti: I pranuar

3) Neni 2.1 h) sugjerojë që fjalia “Kodet Operacionale” të fshihet dhe të përdoret fjalia “licencës përkatëse” në fund të fjalisë

Komenti: I pranuar

4.) Sipas Nenit 1.3 – ky Rregull nuk ka të bëjë me ndonjë konstruktim të linjave të gazit – prandaj sugjerojë ndryshimin e Nenit 1.3 me ” Gazi Natyror dhe të gjitha çështjet në lidhje me **furnizimin dhe shërbimet e gazit natyror** nuk janë të mbuluara nga ky Rregull”.

Komenti: I pranuar

5) Neni 2.2 duhet të ndryshohet që të reflektojë saktë shtojcat dhe duhet të jetë si në vijim: “Format e aplikimeve për **kyçje dhe furnizim, oferta për kyçje dhe kontrata për furnizim** të përfshirë në shtojcat e **kësaj Rregulli**, japin vetëm elementet bazë që duhet të përmbajnë dokumentet përkatëse; furnizuesi mund t’u shtojë këtyre formave çfarëdo informate tjetër të nevojshme, në rast se këto informata janë në pajtim me parimet e vendosura në këtë Rregull, dhe nuk bien ndesh me to në asnjë mënyrë”.

Komenti: I pranuar

6) Në Nenin 4.3 paragrafi m) jam dakord që termi “deklaratë” duhet mirë të qartësohet derisa nuk jep kuptim të qartë se për çfarë “deklaratë” bëhet fjalë (financiar, komercial apo diçka lidhur me rregullat e Tregut)

Komenti: Pranohet dhe do të jetë si në vijim m) botojë në faqen elektronike zyrtare dhe gazetat ditore, deklaratën mbi Metodologjinë e Taksave për Kyçje të aprovuar nga ZRRE-ja;

7) Neni 4.3, paragrafi n) duhet të ndryshohet me n) detyrimet dhe përgjegjësitë tjera siç janë vendosur në këtë

Koment: Të fshihet paragrafi n)

8) Shikoje referencën e përdorur në Nenin 11 (tani 12) dhe “paragrafi 22” – duhet të jetë “Neni 22” – shikoje në Rregullat e Tregut.

Komenti: I pranuar

9) Në Nenin 14.2 (tani 15.3) shprehja “Shtojca XX dhe YY” duhet të zëvendësohet me “Shtojcën A”

Komenti: I pranuar

10) Në Nenin 14.5 (tani 15.5) në vend “depozitë” përdore termin e përdorur në Nenin 21 “depozitë garancie”.

Komenti: I pranuar

11) Në Nenin 15.1 (tani 16.1) ndrysho “Shtojca E” me “Shtojca C”

Komenti: I pranuar

12) Pse Neni 15.4 (tani 16.4) i referohet vetëm Nenit 14.1 kur i gjithë Neni 14 bën fjalë për ndryshimet. Prandaj në vend të referimit në Nenin 14.1 të përdorën referencat e Nenit 14.

Komenti: I pranuar

13) Neni 26.7 (tani 28.7) nuk duhet të përmbajë vetëm detyrimin e furnizuesit që të paraqesë procedurat e tij për shqyrtim por edhe për aprovim të ZRRE-ja. Prandaj pas fjalës “ për rishikim” shtoj edhe fjalën “aprovim”

Komenti: I pranuar

14) Prej Nenit 30.3 (tani 32.3) të fshihet fundi i fjalisë ” në përputhje me Shtojcën XX” derisa nuk ekziston një Shtojcë e tillë që merret vetëm me ngrohjen në këtë Rregull.

Komenti: I pranuar

15) Në nenin 31 numrat mungojnë. Janë dy paragrafë që duhet të radhitën 31.1 dhe 31.2.

Komenti: I pranuar

16) Pjesa e fundit e fjalisë në nenin 32.1 (tani 34.1) “përpos nëse është ndryshe e përcaktuar” do të shlyhet pasi që rregulli hyn në fuqi në datën e aprovimit dhe publikimit në faqen e internetit të ZrRE-së. Përfshirja e frazës “përpos nëse është ndryshe e përcaktuar”, nuk ka ndonjë kuptim, sepse nuk ka mundësi që ndryshe të përcaktohet në momentin kur Rregulli formalisht aprovohet dhe publikohet. Së paku unë nuk shohë ndonjë mundësi. Gjithashtu, përderisa ekziston mundësia për të dhënë përjashtim nga përmbushja e disa obligimeve të këtij rregulli – siç përcaktohet në nenin 33.3 nuk ka kuptim të deklarohet se rregulli mund të aprovohet më vonë se sa në ditën e aprovimit faktik nga Bordi.

Komenti: I pranuar

17) Në gjitha Shtojcat ku është përdorur “KEK” të fshihet dhe të përdoret “furnizuesve” p.sh. në Shtojcën A.

Komenti: I pranuar

18) Numrat dhe forma e Shtojcave duhet të rishikohen dhe të rregullohen. Shtojca E duhet të zëvendësohet me Shtojcën.

Komenti: I pranuar

19) Në Shtojcën C (tani Shtojcën E) – Kontrata për Furnizim radhitja dhe paragrafi i Nenit 6 të rregullohet.

Komenti: I pranuar

20) Në Nenin 8 të Shtojcës C janë dy paragrafë por numrat mungojnë. Prandaj të vendosen numrat 8.1 dhe 8.2. Gjithashtu referimi në Nenin 32 me gjasë është gabim derisa Neni 31 merret me “Gjobat” ose kuptimi i fjalisë është i paqartë për arsye të gjuhës. Gjithashtu në vend të “neni” përdore “Neni” .

Komenti: I pranuar

21) Në Shtojcën C (tani E) Neni 10 i referohet gabimisht Nenit 11 dhe 13 në lidhje me Faturimin dhe Pagesën. Këto referenca duhet të ndërrohen me Nenet 20 dhe 22 të këtij Rregulli.

Komenti: I pranuar

22) Në Shtojcën C (tani E) Neni 11 përmban referim të gabuar ndaj Nenit 14 dhe 15. Do ju sugjeroja që ti referoheni Neneve 23, 24 dhe 30.6 të këtij Rregulli.

Komenti: I pranuar

Komentet e Z. Naim BejtullahuPSE: Nene të reja në Nenin 11

11.5 Mirëmbajtja e kycjes e përcaktuar sipas Nenit 10.2 do të jetë përgjegjësi e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes dhe do të kryhet pa asnjë taksë ndaj konsumatorëve.

11.6. Neni 11.5 nuk do të aplikohet ndaj kyçjeve ekzistuese që janë në pronësi të konsumatorëve. Operatorët e sistemit do të ngarkojnë konsumatorët me tarifa për mirëmbajtjen e këtyre kyçjeve sipas çmimoreve së aprovuar nga ZRRE-ja. Sipas këtij Neni, mirëmbajtja e kycjes përfshin mirëmbajtjen e kablllove/telave të lidhur në rrjetin e operatorit, aparaturat matëse dhe siguresat hyrëse(nëse aplikohen) të kutive matëse.

11.7. Konsumatorët që kanë në pronësi të tyre pika kyçjeje, përfshirë aparaturat matëse, mund t'i transferojnë asetet e tyre tek operatorët e sistemit pa asnjë pagesë pas sjelljes së tyre në gjendje të mirë, siç kërkohet në kodet teknike të nxjerrë nga operatorët e sistemit dhe aprovuar nga ZRRE-ja. Prej datës kur do të bëhet transferimi i këtyre aseteve nga konsumatorët, do të aplikohen dispozitat e Nenit 11.5.

11.8. Në rast të qëllimit të konsumatorëve për të shfrytëzuar dispozitën e Nenit 11.6, operatori i sistemit mund të kërkojë rregullimin e tarifës në përputhje me Rregullin mbi Çmim-vënien dhe Tarifat. Transferimi i mundshëm i aseteve që përcaktohet në Nenin 11.7, do të merret në shqyrtim në përputhje me Metodologjinë e Tarifave të aprovuar nga ZRRE.

Komentet e William Derbyshire NERA - Konsultant

6.1. Operatorët e sistemit duhet të zhvillojnë metodologjinë e taksave dhe procedurat për kyçje në përputhje të plotë me rregullën për "Metodologjinë e Tarifave" të aprovuar nga ZRRE-ja, e që përfshin taksat për:

d) rrethanat kur linjat elektrike, gypat për ngrohje, ose pajisjet energjetike për instalim janë të një madhësie më të madhe se sa është kërkuar për shfrytëzim [a do të thotë kjo 'qasje në rrjetin e aplikantit në mënyrë që të lejohet zgjerimi i ardhshëm?'] të rrjetit;

Pyetje/koment: po, por metodologjia e tarifës në të ardhmen do të marrë ne shqyrtim rimbursimit nga konsumatorët e kyçur rishtas.

6.2 Metodologjia e Taksave për Kyçje duhet të provizionoi apelimet e aplikantëve bërë në ZRRE, kundër ofertave për kyçje që janë nxjerrë prej operatorëve të sistemit;

6.3. Metodologjia taksave për kyçje duhet të dizajnohet në mënyrë që të mos ketë diskriminim ndërmjet shfrytëzuesve të sistemit apo klasave shfrytëzuese të sistemit dhe kyçjeve ekzistuese dhe atyre që janë krijuar pas miratimit të këtij Rregulli. [Ky nen duhet të fshihet ose të ndryshohet. Meqenëse shfrytëzuesit ekzistues nuk do të ngarkohen për kyçjet aktuale, por shfrytëzuesit e rinj po, atëherë ky është një diskriminim I pashmangshëm. Mbase duhet ndryshuar dhe të thuhet se 'Metodologjia e taksave për kyçje duhet të hartohet në atë mënyrë që të mos ketë diskriminim ndërmjet palëve të ngjashme që kyçen në rrjet kur bëhet vënia e taksave për kyçjet e reja ose për zëvendësimin ose ndryshimin e kyçjes ekzistuese.??]

Koment: I pranuar

Neni 7 Aplikimi për Kyçje

Bazuar në Metodologjinë e Taksave dhe procedurave për Kyçje, aplikuesi dorëzon aplikacionin e vet tek furnizuesi i cili e procedon tek operatorët e sistemit, sipas Aneksit A të këtij Rregulli. [shih pyetjen nën 4.3(b). ky përkufizim duket se u kërkon konsumatorëve të privilegjuar dhe prodhuesve që të kontraktojnë me një furnizues për të siguruar kyçjet e tyre]

Komenti: është marrë parasysh në 4.3(b)

8.2. Oferta për kyçje duhet të përmbajë elemente në lidhje me:

- a) ata aplikantë siç është përcaktuar në Metodologjinë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje, masat e nevojshme për të kyçur një shfrytëzues të sistemit në rrjetet ekzistuese të transmetimit ose shpërndarjes si dhe marrjen e pëlqimit të nevojshëm për këtë qëllim; të cilat si rezultat i kësaj janë emërtuar si "kyçje e cekët".
- b) ata aplikantë siç është përcaktuar në Metodologjinë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje, punët e nevojshme për zgjerim ose përfundim të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes, për të rregulluar kërkesën e supozuar ose kriteret për kapacitet të aplikantit; në këtë mënyrë i emërtuar si "kyçje e thellë".

- c) për ata aplikantë që furnizohen në një nivel të caktuar tensioni dhe që bien brenda një kërkesë maksimale dhe që gjenden në distancë nga rrjeti ekzistues i shpërndarjes, një taksë standarde të kyçjes që përcaktohet në Metodologjinë e Tarifave dhe në Metodologjinë e Taksave për Kyçje;

Koment: Pranohet

8.8. Në rast të vendosjes së kyçjes për një konsumator të kualifikuar, oferta dhe marrëveshja për kyçje mund të nxirret dhe të dorëzohet pa përfshirë furnizuesin. Konsumatori i privilegjuar në atë rast mund të nënshkruajë Marrëveshjen për Hyrje, e cila vendos detyrim për t'u përputhur me Rregullat e Tregut. **[A nuk do t'i duhej konsumatorit të privilegjuar që ka dëshirë të nënshkruajë Rregullat e Tregut të marrë një licencë furnizimi? Në rast të tillë ata duhet të aplikojnë njësoj si çdo furnizues tjetër]**

Koment: Pranohet

8.9. Afati i fundit për dorëzim të ofertës për kyçje mund të zgjatet në rast të ndonjë kyçje të vështirë që lë të nënkuptohet një studim paraprak teknik për zgjerim të rrjetit ose të çfarëdo arsye të thjeshtë në përputhje me dispozitat e kodit të rrjetit dhe shpërndarjes ose kodeve tjera të aplikueshme. **Në këto raste, studimi duhet të përfundohet brenda nëntëdhjetë (90) ditësh kalendarike prej ditës së dorëzimit të aplikacionit për kyçje dhe oferta për kyçje duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditësh prej përfundimit të studimit përkatës.**

Koment: Pranohet

8.10 Në rast të një kontesti në lidhje me kushtet e ofertës për kyçje, Metodologjia e Taksave për Kyçje, do të bëjë të mundur që aplikanti të bëjë vetë studimin teknik me shpenzimet e veta, dhe që operatori i sistemit të bëjë të mundur lehtësimin e një studimi të tillë përmes dhënies së informacioneve të nevojshme për të cilët mund të vendoset një taksë e përshtatshme.

Koment: Pranohet

9.2. Në këtë rast një njoftim në formë të shkruar që identifikon arsyen e refuzimit duhet të lëshohet dhe dërgohet te aplikuesi brenda kohës që nuk tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dërgimit të aplikacionit, përkatësisht brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në Nenin 8.9. **[a nuk duhet që afatet përfundimtare të përputhen me ato në Nenin 8? Mund të jetë e mundur vetëm të identifikohet që një kyçje nuk është teknikisht dhe ekonomikisht e mundshme pas një studimi teknik]**

Koment: Pranohet dhe është përfshirë në rregull

9.4. Në rast të refuzimit aplikuesi ka të drejtën e ankesës në ZRRE. Operatori i sistemit në njoftimin me shkrim duhet ti referohet të drejtës së aplikuesit që të apeloj në pajtim me Rregullën mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve. **[kam shtuar një dispozitë më të përgjithshme për apelet në Seksionin 6 – pasi aplikanti mund të dëshirojë të apelojë kushtet si dhe të refuzojë që të bëjë një ofertë për kyçje. Gjithashtu, a duhet që apelimet të ndjekin Rregullin për Zgjidhjen e Kontesteve apo të bëhen përmes një rruge të përkrahur në Metodologjinë për Tarifave e Kyçjes (të paktën në fillim)? Unë preferoj këtë të fundit pasi ka çështje, si lejimi që aplikanti të bëjë studimin e vet teknik I cili do të përfshihet në apel por që mund të mos mbulohet sipas Rregullit mbi Zgjidhjen e Kontesteve]**

Koment: Pranohet dhe meqë neni 6 ka dhënë të drejtën e përgjithshme për çdo apel që do të mbulohet sipas Procedurave të Zgjidhjes së kontesteve, atëherë do të jete me e përshtatshme të zhvillohen dispozita në Metodologjinë e tarifave, të cilat rastet për apel i marrin në shqyrtim në një mënyrë me specifike.

11.5. Mirëmbajtja e **elementeve të kyçjes së thellë** do të jetë përgjegjësi e Operatorëve të Sistemit të Transmetimit dhe Shpërndarjes dhe do të kryhet pa asnjë pagesë shtesë nga ana e konsumatorëve. **Operatori i Sistemit do të jetë i autorizuar të vendosë një tarifë të përshtatshme fillestare për kostot e kapitalizuar të mirëmbajtjes së kyçjeve të cekëta që aplikohen në një mënyrë të pa-diskriminuar ndaj të gjithë shfrytëzuesve të këtyre kyçjeve.**

Koment: Pranohet

11.6. Neni 11.5 nuk do të aplikohet ndaj kyçjeve ekzistuese që janë në pronësi të konsumatorëve. Për mirëmbajtjen e këtyre kyçjeve, operatorët e sistemit do të ngarkojnë konsumatorët në mënyrë të vazhdueshme sipas çmimoreve të aprovuar nga ZRRE-ja, dhe me tarifa të cilat do të mund të rregullohen në mënyrë të përshtatshme. Sipas këtij Neni, mirëmbajtja e kyçjes përfshin mirëmbajtjen e kabllave/telave të lidhur në rrjetin e operatorit, aparaturat matëse dhe siguresat hyrëse (nëse aplikohen) të kutive matëse. **[a u lejohet konsumatorëve të ndërmarrin mirëmbajtjen e tyre sipas kriterit për t'u pajtuar me kodet teknike? Për shembull, Feronikeli mund të dëshirojë të bëjë një gjë të tillë]**

Komenti: Pranohet

Pyetje: kush ka për të transferuar asetet tek operatorët tek të cilët kanë mundësi, me kusht që t'i sjellin në standardet teknike që kërkohen prej kodeve. Kjo mund të aplikohet në rastin e Feronikelit, dhe tarifa e transmetimit në tensionin 220kV duhet që të rregullohet, si dhe të paguhet nga Feronikeli.

11.7. Konsumatorët që kanë në pronësi të tyre pika kyçjeje, përfshirë aparaturat matëse, mund t'i transferojnë asetet e tyre tek operatorët e sistemit pa asnjë kompensim pas sjelljes së tyre në gjendje të mirë, siç kërkohet në kodet teknike të nxjerrë nga operatorët e sistemit dhe aprovuar nga ZRRE-ja. Prej datës kur do të bëhet transferimi i këtyre asetëve nga konsumatorët, do të aplikohen dispozitat e Nenit 11.5. **Asetet e transferuara do të përfshihen në bazën e asetëve të operatorit të sistemit që shfrytëzohet për qëllimet e aprovimit të tarifave të rregulluara nga ZRRE-ja, në përputhje me parimet e përcaktuara në Metodologjinë e Tarifave.**

Komenti: Pranohet dhe është përfshirë

Neni 13 Hyrja në Shfrytëzim të Sistemit

13.1. Me qëllim të qasjes në shfrytëzim të sistemit, Pala Aplikuese **ose do të jetë nënshkruese e Marrëveshjes Kornizë, ose do të nënshkruajë Marrëveshjen për Hyrje me Operatorin e Tregut në rolin e vet si Palë e Autorizuar sipas Marrëveshjes Kornizë** (tani e tutje "Pala e Autorizuar").

Komenti: Pranohet dhe është përfshirë

15.4. Furnizuesi shqyrton, aplikacionin brenda 30 ditëve prej datës së pranimit **dhe nxjerr njoftim me shkrim në lidhje me synimin e vet për të pranuar ose refuzuar aplikacionin.** Ky afat kohor mundet të zgjatet për (15) ditë kalendarikë të tjera në rastet kur kërkohen informata shtesë. Aplikuesi duhet të informohet rreth këtyre zgjatjeve me shkrim.

Komenti: Pranohet dhe është përfshirë

Neni 32 Dispozitat e Përkohshme

32.2. Brenda periudhës së ardhshme kohore tre (3) mujore **[[forma e marrëveshjes për kyçje, sipas Nenit 32.8, do të jetë në dispozicion vetëm 4 muaj pas hyrjes në fuqi të rregullit. Mbase të ndryshohet një nga afatet përfundimtare?]** pas paraqitjes së aplikacionit për kyçje, furnizuesi publik duhet të implementojë dispozitat e Nenit 10 dhe të

nënshkruajë me operatorin e sistemit një marrëveshje të vetme për kyçjen e të gjithë konsumatorëve [jo të privilegjuar?] ekzistues.

Pyetje: po marrëveshja e nënshkruar do të hyjë në fuqi pas 7(shtatë) muajsh. Duket pak gjatë por meqë është në pyetje arritja e një marrëveshjeje që do të ketë mundësi të zbatohet në një mënyrë cilësore, ne jemi në një pozicion që të lejojmë më shumë kohë që palët të vlerësojnë situatën reale dhe të identifikojnë dobësitë e kyçjeve dhe të përcaktojnë detyrimet kontraktuale që mund të përmbushen. Në veçanti, duhet zëvendësuar situata aktuale organizative në KEK ku furnizimi kryen disa funksione që i përkasin rrjetit. Ky veprim kërkon kohë dhe përpjekje.

Nuk ka dallim midis konsumatorëve të privilegjuar dhe jo të privilegjuar sepse konsumatorët e privilegjuar kanë mundësinë të veprojnë si furnizues për vetëfurnizim ose nën ombrellën e ndonjë furnizuesi të licencuar.

32.2. Brenda periudhës së ardhshme kohore tre (3) mujore pas paraqitjes së aplikacionit për kyçje, furnizuesi publik duhet të implementojë dispozitat e Nenit 10 dhe të nënshkruajë me operatorin e sistemit një marrëveshje të vetme për kyçjen e të gjithë konsumatorëve ekzistues [jo të privilegjuar?]. Përpara hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, operatorët e sistemit do të vazhdojnë të japin shërbime për konsumatorët ekzistues me të njëjtat kushte dhe afate si ka qenë përpara miratimit të këtij Rregulli

Pyetje: njësoj si në Nenin 32.2

Komenti: Pranohet dhe është përfshirë

Neni 8 Kufizimet e Furnizimit për shkak të Rrjetit

8.1. Në rast të kufizimit të furnizimit për shkak të kushteve të rrjetit, furnizuesi ka të drejtë që t'ju ofroi konsumatorëve sasi të kufizuar të energjisë. Në raste të tilla furnizuesi do të përpiqet sa më shumë që është e mundur që të informoi konsumatorët së paku njëzet e katër (24) orë më herët... [A e përfshin 'rrjeti' limitet në saje të mungesës në kapacitetet gjeneruese?]

8.2. Aplikimi i paragrafit të mëparshëm mund të konsiderohet vetëm për rastet të përshkruara në Nenin 33 të Rregullit për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. [?? Neni 33 I referohet heqjeve prej obligimeve të kontratës për furnizim]

Pyetje: mungesa e kapaciteteve gjeneruese ose ndonjë kusht tjetër kufizues, mbulohet prej Rregullit mbi Masat Kufizuese të Furnizimit me Energji që është nxjerrë nga MEM-i.

Komentet nga KEMA të bëra nga Bob McVean, Eric Davidson, Maurice Smith 17 Maj 2006

Të Përgjithshme

1. Rregulli 28.2 citon 'NË rast të ndonjë kontesti, Versioni anglisht do të mbizotëroi.' Po ka disa vende ku janë përdorur fjalë të gabueshme dhe posaçërisht 'thought' në vend të 'through' Rregulli 21.3.

Koment: I pranuar

2. Ne rekomandojmë se do të ketë ndarje të qartë të dispozitave për konsumatorët furnizuesi i të cilëve në emër të tyre do të lidhë marrëveshje për kyçje nga këto dispozita për konsumatorët të cilët kanë nevojë për marrëveshje të veçantë për kyçje.

Koment: Rekomandimet e sugjeruara veç se janë përfshirë. Vetëm konsumatorët e kualifikuar kanë të drejtë të përfundojnë Marrëveshjen për Kyçje.

Komentet specifike

1. Siç e kuptojmë ne këto janë më shumë se si do të jetë e nevojshme të funksionojnë se sa që janë të shkruara.
2. 3. – kjo nuk është në rend alfabetik në anglisht dhe nëse ka terme specifike do të definohen më mirë këtu ato vetëm po ju referohen dokumenteve të tjera

Komenti: I pranuar dhe do të futet në versionin final para se të publikohet.

3. 4.2.(a) dhe 6 – Sugjerojmë që kjo të jetë e limituar vetëm për konsumatorët me kyçe dhe ngarkesë standarde. Çështjet komplekse më mirë zgjidhen drejtpërdrejt në mes të operatorit të sistemit dhe konsumatorit që I kupton se çfarë janë ato.

Koment: Nuk pranohet. Marrëveshja për Kyçe ndërmjet OS dhe Furnizuesit duhet të përcaktojë procedurë të pastër të involvimit të thellë të operatorëve në rast si më lartë.

4. 4.2 (j) - ' . . . dhe fjala 'content' duhet të fshihet. Është e arsyeshme që ZRRE-ja të aprovoi formën e të gjitha kontratave për të siguruar transparencë por nuk duhet të aprovoi të gjithë përmbajtjen e aplikueshme për konsumatorët në tregun konkurrues. Përndryshe nuk është treg konkurrues.

Komenti: I pranuar

5. 4.3 (b) – çdo kush që mbulohet nga kodi I rrejtës duhet të veprimi konformë kërkesave të këtij kodi. Në 4.3 (b), 7.6 (a) dhe (b), 7.8 (a), 8.2, 14.3, 30. Janë afatet kohore. A janë ato në përputhje?

Komenti: Po ato janë në përputhje

6. 4.3 (e) – Nëse “shfrytëzuesit e sistemit” e kanë edhe këtu të njëjtin kuptim ashtu siç është definuar në Ligjin për Energji Elektrike, atëherë duhet të shtohet “ose drejtpërdrejt ose përmes furnizuesit”.

Komenti: I pranuar

7. 5.1 – Ashtu siç është draftuar, përdorimi i fjalës 'charges (Pagesa)' me shumë se sa 'provizion(masa)' ose njëjtë në seksionin e mëhershëm kolona sugjeron pagesa individuale dhe kjo nuk do të kishte kuptim – posaçërisht në rastin (g) dhe (h). Kjo ndoshta duhet të rridhet për tu përmirësuar.

Komenti: I pranuar

8. 5.1 (e) – pse është përfshirë 'mirëmbajtja dhe riparimi'? Ne mendojmë që furnizimi dhe instalimi të jenë pjesë e pagesës për kyçe dhe mirëmbajtja dhe riparimi të jenë pjesë e pagesës TUOS/DUOS (duke I përdorur shprehjet e njëjta ashtu siç janë dokumentin e ZRRE-së 'Metodologjia Tarifore për Sektorin e Energjisë Elektrike').

Komenti: Derisa Rregullat e Tregut janë organizuar ndryshe dhe Marrëveshja për Shfrytëzim të Sistemit nuk është e nevojshme të zhvillohet taksat për TUOS dhe DUOS siç janë përcaktuar në Metodologjinë e Tregut do të konsiderojnë “mirëmbajtjen dhe riparimin” por në Marrëveshjen për Kyçe duhet të provizionohen obligimet reciproke ndërmjet palëve kontraktuese.

9. 7.3 (a) – Varësisht nga pozita në lidhje me të drejtat e operatorit të sistemit për qasje në tokë për ndërtim të rrjetit në Kosovë, mund të jetë e nevojshme të shprehet kjo në afatin kohor pas dhënies së këtyre të drejtave – dhe të vendos detyrimet OS për ti kërkuar ato.

Koment: Kjo çështje nuk është subjekt i këtij Rregulli. Qeveria veç se ka lëshuar Rregullin në lidhje me këtë.

10. 7.6/7.8/8.2 – Periudhat kohore të lejuar në këtë seksion nuk përputhen. Ashtu siç është draftuar, I lejohet operatorit të sistemit të marr tërësisht 120 ditë për të kryer studimin dhe për të vendosur se si do të bëhet kyçja port e lejoj vetëm 30 ditë për të përcaktuar që është e pamundur të ofrohet një. Një ridraftim për të kërkuar refuzim të shpejtë ku një mund të bëhet pa u kryer ndonjë studim domethënës por lejon rezultate të një studimi të rëndësishëm (në më pak se 120 ditë) për të përcaktuar rezultatin që preferohet.

Koment: I pranuar

11. 9.2 - fjala 'draft' duhet të fshihet. Për këtë fazë duhet të jetë përfundimtare. Për transmisionin e mbuluar në kodin e rrjetit elektrik.

Koment: I pranuar

12. 12 - 13 – siç është hartuar, kjo mund të aplikohet vetëm ndaj konsumatorëve të privilegjuar por në këtë rast, kjo nuk është bërë e qartë. Duhet të përcaktohen fjalët që janë me ngjyrë të zezë të fortë në tekst (çfarë është një 'aplikant palë').

Koment: Neni 12 dhe 13 nuk vlen vetëm për hyrjen në Tregun e Brendshëm të konsumatorëve të kualifikuar. Komenti në lidhje me “Pala Aplikuese” është pranuar dhe do të jetë pjesë e definicioneve.

13. 16.1 – Sugjeroj se ky nen ka nevojë të paraprihet nga 'përveç nëse është dhënë si në nenin 14,'.

Koment: I pranuar

14. 17.2 – sugjeroj që fjalët 'duke marrë parasysh çdo ndryshim në tendencat e konsumit nga ana e konsumatorëve, nëse është e përshtatshme' duhet të shtohet në fund. Përndryshe, ka shumë arsye se pse konsumatorët mund të dëshirojnë të vonojnë qasjen në njehsorët.

Koment: I pranuar

15. 19 – parimi këtu është në rregull, por këtu ka disa çështje. Për konsumatorin e arsyeshëm, kjo është siç duhet të jetë. Për konsumatorët që nuk duan të paguajnë faturat e tyre, hapi i parë është të deklarohet se ka një gabim në njehsor dhe se ai duhet të testohet. Historikisht, furnizuesit e integruar vertikalisht kanë pasur tendencën që të njohin se cilët konsumatorë binin në cilën kategori dhe kanë zhvilluar procedurat e mbledhjes së borxheve sipas kësaj. Me hyrjen e ndarjes së biznesit dhe me mbërritjen e furnizuesve të rinj, është shumë e lehtë për furnizuesin të mbështesë konsumatorin dhe të pyesë operatorin e sistemit për të testuar njehsorët – ku kostoja mbahej nga operatori i sistemit. Rregullat e propozuar për Kosovën, nuk përfshijnë mundësinë për të filtruar kërkesat. Nëse mbetet ky parim, atëherë operatori i sistemit do të ketë të drejtën të ngarkojë me

pagesë në rast se nuk është gjetur defekt tek pajisjet, – mund të shtohet në kodin e matjes. Sipas këtij kodi do të ekzistojë gjithmonë e drejta për të bërë apel në ZRRE.

Koment: Mund të jetë në Kodin e Matjes por shpenzimet në rast kërkesë nga konsumatori rezulton pa asnjë gabim atëherë ato duhet të mbulohen nga konsumatori.

16. 20.3 – Sugjerohet që kjo të shkruhet, "në rast të ndonjë gabimi që rezulton në lexim të pasaktë të të dhënave të njehsorit, gjë që shkakton faturim të pasaktë, furnizuesi të bëjë të gjitha rregullimet e nevojshme në faturën vijuese." Mund të ketë më shumë faktorë sesa 'rregullim i pasaktë i njehsorëve' që mund të shkaktojnë faturim të pasaktë.

Koment: I pranuar

17. 23.2 – sugjerohet që norma e interesit të përcaktohet kundrejt normës bazë të një banke të njohur dhe jo të rregullohet. Çështja është se furnizuesi ka planifikuar që të plotësojë kriteret e veta operationale për një nivel të caktuar të ardhurash, dhe nëse paratë që janë për t'u paguar nuk futen siç janë pritur, atëherë financimi afatshkurtër duhet të vijë nga një burim tjetër. Konsumatorët do t'i nënshtrohen të njëjtave luhajtje të normave të interesit si furnizuesi, dhe, meqenëse kjo tashmë është draftuar (hartuar) atëherë në varësi të diferencës midis normës fikse në rregulla dhe normave fleksibile të tregut, mund të jetë e dobishme që vonohen pagesat ndaj furnizuesve ose normat e tarifuar mund të jenë shumë më tepër ndëshkuese se sa është e arsyeshme.

Koment: Është konsideruar por në rastin e Kosovës në bazat e përkohshme sepse tregu financiar nuk është i zhvilluar dhe normat aktuale të interesit duhet të adoptohen dhe monitorohen nga ZRRE-ja.

18. 26.1 – në rregull por unë sugjerohet një shtesë në nenin 5.1 të rregullit mbi shkyçjen. Në këtë nen lini një periudhë pas 'ndërmarrje' dhe fshini pjesën e mbetur.

Koment: Sugjerimet do të konsiderohen në të ardhmën.

19. 26.5 – kjo duket se jep trajtim favorizues ndaj konsumatorëve jo shtëpiakë. Pse bëhet ky diskriminim?

Koment: Vendim politik i marrur më herët.

20. 27.1 – një pagesë e vogël shtesë për të mbuluar kostot që nuk janë 'direkte dhe tregueshme' dhe që synon një farë kompensimi për shqetësimin duket se është e arsyeshme këtu.

21. 30.8 – Sugjerohet që ky të ndahet në dy seksione ku 'transmetimi' futet midis tyre. 'The' dhe 'sistemi' në rreshtin e parë të paragrafit të ri 30.8 i cili më pas do të ketë nënpikat (a) dhe (b). Më pas paragrafi i ri 30.9 do të shkruajë, 'operatori i sistemit të shpërndarjes brenda (120) ditësh kalendarike të miratimit të këtij Rregulli, do të dorëzojë në ZRRE format standarde të marrëveshjes për kyçjen e shpërndarjes.'

Koment: I pranuar